

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.02.2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtorëve të Drejtorive të Urbanizmit të Komunave
CC:	z.Ferid AGANI, Ministër i MMPH-së Kryetareve të Komunave të Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shtyerjen e afatit për regjistrimin e ndërtimeve pa leje

Të nderuar,

Sipas nenit 5 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 04/L-188 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, procesi i regjistrimit të ndërtimeve pa leje përfundon më datën 05.02.2015.

Procesi i Regjistrimit të Ndërtimeve pa leje ka filluar në të njëjtën kohë dhe me procedura të unifikuara në tërë territorin e vendit tonë. Procesi ka rezultuar me një bashkëpunim të shkëlqyeshëm në mes të Ministrisë dhe të gjitha komunave.

I falënderojmë të gjitha ato komuna që me punën e tyre të palodhshme kanë regjistruar me mijëra ndërtime pa leje. Njëkohësisht, duke u bazuar në dinamikën e regjistrimit dhe sipas kërkesave të shumicës së komunave, ky proces duket se nuk mund të përfundojë më datën e caktuar me ligj. Shtojmë këtu edhe mos fillimin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në disa komuna, si rrjedhojë mund të konkludohet se afati për regjistrimin e ndërtimeve pa leje kërkon edhe një kohë shtesë për përfundimin e tij.

Arsyet kryesore për shtyrjen e afatit për regjistrimin e ndërtimeve pa leje, të identifikuar nga Ministria pas kontakteve të vazhdueshme me komunat, janë:


- Procesi i regjistrimit të Ndërtimeve pa leje ka filluar vonë por ka filluar me një entuziazëm të madh nga vetë komunat si dhe nga qytetarët, andaj është shumë me rëndësi që vazhdimi i regjistrimit të ndërtimeve të bëhet pa e ndërprerë kontinuitetin e këtij procesi.
- Sipas informatave nga komunat, për t'i regjistruar të gjitha ndërtimet pa leje në territorin e tyre, komunave ju nevojitet kohë shtesë meqenëse ka interesim të madh të qytetarët dhe koha për regjistrim deri më 5 shkurt 2015 nuk është e mjaftueshme.
- Si rezultat i kampanjës publike të organizuar nga Ministria dhe komunat, opinioni publik është sensibilizuar dhe qytetarët masovikisht i janë përgjigjur procesit të regjistrimit. Sipas të dhënave nga Ministria, gjer më tani janë regjistruar më shumë se 95000 ndërtime pa leje.

Duke e marrë parasysh situatën në të cilën jemi dhe duke u bazuar në Ligjin për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, Ministria i jep instruksionet si në vijim:

1. Nga 5 shkurti deri më 11 qershor, komunat mund të vazhdojnë të pranojnë kërkesat për tu listuar në Regjistër (shtojca 1).
2. Komunat duhet të informojnë qytetarët/aplikuesit që kërkesa e tyre do të konsiderohet si "ankesë" sipas Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, neni 4 paragrafi 4 (shtojca 2).
3. Njoftojmë komunat se sipas nenit 5 paragrafit 2 të Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, Komunat janë përgjegjëse për të kompletuar listën me të gjitha ndërtimet pa leje që janë të mbuluara me këtë Ligj, për ndërtimet e përfunduara apo të filluara para datës 30 gusht 2013. Gjatë kësaj kohe ju gjithashtu duhet të përfundoni punën në identifikimin e të gjitha ndërtimeve pa leje në tërë territorin e Komunës tuaj.
4. Gjithashtu, njoftojmë komunat se brenda disa javëve Ministria do të nxjerr Udhëzimin Administrativ për procedurat e ankesave ku do të përfshihen dhe qartësohen të gjitha hapat e proceduarve të ankesës.

Me shume hollësi te shpjegimit Ligjor mund të gjeni ne shtojcën 3.

Me respekt,



Kërkesat për Regjistrim do te pranohen deri më 11 qershor 2015

Shtojca 2

VËREJTJE:

Ju faleminderit për dorëzimin e formularit të regjistrimit për pëfshirjen e ndertimit tuaj në Regjistrin e ndërtimeve pa leje. Afati për regjistrim ka qenë 5 shkurti 2015. Megjithatë, regjistrimi i juaj po shqyrtohet si ankesë në pajtim me Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, neni 4 paragrafi 4 dhe ky ndërtim do të futet në Regjistër.

Ju duhët të parashtrooni kërkesën për legalizim. Ju lutëm ti përcillni afatet. Informata shtesë mund të gjeni në:

<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990>



Legalizo Ndertimin

OBAVEŠTENJE:

Hvala vam na podnošenju obrasca za registraciju za unošenje vaše građevine u Registar građevina bez dozvole. Rok za registraciju je bio 5. februar 2015. Međutim, vaša se registracija razmatra u obliku žalbe na osnovu Zakona o tretiranju izgradnje bez dozvole, član 4. stav 4. i navedena građevina će biti uneta u Registar.

Vi trebate da podnesete zahtev za legalizaciju. Molimo vas pratite rokove.

Dodatne informacije možete naći na:

<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990>



Legalizo Ndertimin

NOTICE:

Thank you for submitting your registration form to include your construction in the Registry of Unpermitted Constructions. The deadline for registering was February 5, 2015. However, your registration is being considered as an appeal according to the Law for Treatment of Constructions without Permit, Article 4, paragraph 4 and this construction will be entered into the Registry.

You will need to file an application for legalization. Please pay attention to deadlines.

Additional information can be found at:

<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990>



Legalizo Ndertimin

Shtojca 3

Baza ligjore:

1. Komunat kanë 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që të identifikojnë ndërtimet pa leje brenda territoreve të tyre. (Ligji, neni 5, paragrafi 2-3). **AFATI I FUNDIT = 5 shkurt 2015**
2. Njëkohësisht komunat i pranojnë kërkesat për përfshirje në Regjistër. (Ligji, neni 5, paragrafi 3)
3. Komunat ia dërgojnë regjistrat Ministrisë brenda 12 muajve dhe 5 ditëve pas hyrjes në fuqi të ligjit. (Ligji, neni 5, paragrafi 2) **AFATI I FUNDIT = 10 shkurt 2015**
4. Ministria më pas i ka 30 ditë për t'i përfshirë regjistrat komunal në një Regjistër Kombëtar dhe për t'ia publikuar qytetarëve për të parë nëse ndërtimet e tyre janë publikuar. (Ligji, neni 4, paragrafi 2). **AFATI I FUNDIT = 12 mars 2015**
5. Megjithatë, pasi që ministria e ka krijuar softuerin e bazës së të dhëna për ndërtim të Regjistrit, të dhënat komunale tanimë janë grumbulluar. Prandaj nuk ka nevojë që komunat t'i dërgojnë regjistrat e tyre.
6. Përveç kësaj, pas regjistrimit të Regjistrit për shqyrtim publik, kërkesit dhe palët tjera të interesuara mund të parashirojnë ankesa. Bazë për ankesë mund jenë:
 - a. Përfshirja në Regjistër e një objekti i cili nuk do të duhej të përfshihej sepse është ndërtuar ose ka filluar të ndërtohet para datës 30 gusht 2013 me leje ose për ndërtimin e tij nuk ka pasur nevojë për leje, ose nëse është dhënë ndonjë leje tjetër nga një organ shtetëror për ndërtim të tij; ose
 - b. Ndërtimi nuk është përfshirë në Regjistër dhe është dashur të përfshihet sepse është ndërtuar ose ka filluar të ndërtohet para datës 30 gusht 2013 dhe nuk ka pasur leje të ndërtimit; ose
 - c. Përfshirja në Regjistër e një objekti i cili është ndërtuar ose ka filluar të ndërtohet pas datës 30 gusht 2013 dhe nuk kualifikohet për trajtim sipas këtij Ligji. (Ligji, Neni 4, para.4)
7. Në bazë të 6(b) më sipër, bazë për ankesë është që ndërtimi nuk është në Regjistër, por duhet të ishte. Kjo është njëjtë sikurse të kërkohej që ndërtimi të futet në regjistër përmes dorëzimit të formularit për regjistrim.
8. Sipas nenit 19, paragrafët 3.2 dhe 3.3, Ministria ka autoritetin për vendosjen e procedurës së ankesës dhe të gjitha çështjet tjera të nevojshme për zbatimin e ligjit.
9. Në bazë të këtij autoriteti, Ministria ka përcaktuar që kërkesat për përfshirje në Regjistër të cilat janë dorëzuar pas 5 shkurtit 2015, të konsiderohen si ankesa.
10. Prandaj Ministria po i udhëzon komunat që të vazhdojnë me pranimin e kërkesave për përfshirje në Regjistër gjer në fund të periudhës së ankesës, do të thotë gjer më 11 qershor 2015.
11. Ministria gjithashtu synon nxjerrjen e një udhëzimi administrativ i cili e qartëson këtë procedurë.